



Duke u mbështetur në nenin 40 al. 40.2 nën 1) Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, , nenit 10 dhe 40.2 nën pikën 11 të Statutit të Komunës, nenit 8 i Rregullores Komunale për Transparencë 01nr.031-5713/2014 e dt.26.12.2014 Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të rregullt, të mbajtur më 25.11.2016, mori këtë:

V E N D I M

Për

Vënien në Diskutim Publik të Draft –Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Adem Jashari “ Klinë

- I Miratohet vendimi për venje në diskutim publik të Draft –Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Adem Jashari “ Klinë.
- II Venja në Diskutim Publik e kësaj Draft –Rregulloreje bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga të gjitha institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët që e njëjta të jetë sa më funksionale nga subjektet implementues dhe të tjerë.
- III Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin Draft –Rregulloren për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Adem Jashari “ Klinë, në Drejtorinë përkatëse apo në Shërbimin për Punë të Kuvendit në objektin e Komunës.

Vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të dorëzohen në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit apo Shërbimin për Punë të Kuvendit.
- IV Drejtoria Komunale e Kulturës Rinisë dhe Sportit duhet të informojë Kuvendin me propozimet e dhëna duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh.
- V Kuvendi i Komunës propozimet e argumentuara dhe të mbështetura në ligj, të përfshira në tekstin përfundimtar të këtij Drafti do t'i ketë parasysh me miratimin e tij.
- VI Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL.

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim .

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-4805 /2016
Klinë, më 30.11 /2016

